



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 12.12.2016

Vendim
Nr. 82, datë 12.12.2016

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE MËSIMORE DHE
KËRKIMORE-SHKENCORE NË NJËSITË BAZË TË FAKULTETIT TË
SHËNDETIT**

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të rekomandimeve të MAS për organigramën e fakulteteve dhe mungesën e grupeve mësimore e kërkimore (Raporti i Inspektimit nr 5265, prot, datë 01. 08. 2014, faqe 7), dhe në zbatim të Vendimit Nr. 32 të Senatit Akademik, datë 06. 09. 2016, "Për fillimin e procesit të riorganizimit akademik dhe administrativ të institucionit dhe hartimin e strukturës së përgjithshme të tij", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.12.2016

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë bazë të Infermierisë dhe Kujdesit Shëndetësor.
2. Në Njësine bazë të Infermierisë të ngrihen dhe funksionojnë *Grupi mësimor i infermierisë*, dhe *Grupi kërkimor-shkencor i infermierisë*.
3. Në Njësine bazë të Kujdesit Shëndetësor të ngrihen *Grupi mësimor i Kujdesit shëndetësor* dhe *Grupi kërkimor-shkencor i politikave shëndetësore*.
4. Kjo njësi bazë dhe emërtimi i saj të reflektohet në strukturën dhe organikën e re të Fakultetit të Shëndetit dhe Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, Kancelari, zv/Rektori, Dekani i Fakultetit të Shëndetit, përgjegjësit e njësive bazë të Fakultetit të Shëndetit, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
6. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.